



|                                        |            |
|----------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO |            |
| KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN    |            |
| 01 Nr. / Br                            | 46/24      |
| Nr. i fq. / Br. gt                     | - 4 -      |
| Data: / Datum                          | 15.03.2024 |
| VUSHTRRI - VUČITRN                     |            |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

### PROCESVERBAL

**nga mbledhja e II-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 shkurt 2024  
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakele Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Nurie Halili.

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova (Nënkryetar i Komunës), drejtorët e drejtorive, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo tha se si pikë shtesë për t'u futur në rend të ditës e kemi < Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023>, e cila ka qenë me Plan të Punës së Kuvendit, por që policia e ka sjellë me vonësë.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – tha se ndoshta jam bërë i tepërt me kërkesën time lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Mbeturina, për shkak se tarifat për biznese janë tepër të larta. Ka biznese që me rregulloren aktuale paguan 300-400 euro në muaj. NPL "Përparimi" ka filluar të dalë në terren dhe t'i bëjë kontratat me biznese, se di kjo çështje qysh është e rregulluar. A kanë të drejtë kompania, apo bizneset duhet të vijnë në komunë për ta bërë kontratën.

Është mirë që kjo rregullore të bëhet sa më shpejt dhe të detajizohen çështjet.

Në kohën sa kam qenë drejtor i Drejtorisë për Inspektime, ky ka qenë problemi kryesor me bizneset, sepse nuk paguanin mbeturina me këto çmime të larta. I hudhnin mbeturinat nëpër kontejnerë të banesave. Prandaj, ta bëjmë një zgjidhje për këtë çështje.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkryetar i komunës** – deklaroi se këtë çështje e kemi diskutuar me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe me NPL "Përparimi", ku ka pasur shumë ankesa nga bizneset sa i përket tarifës, sepse është e lartë për një pjesë të bizneseve. Kjo për shkak se nuk është bërë kategorizimi i bizneseve për pagesë.

Komisioni është formuar dhe janë duke punuar në hartimin e rregullores dhe besoj që së shpejti do të del në konsultim publik dhe pastaj do të vjen në kuvend për aprovim.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tha se pasi që u ngrit si çështje Rregullorja për Mbeturina, nënkryetari i dha disa sqarime adekuate. Por, ata që e plotësojnë dhe ndryshojnë këtë rregullore duhet ta kenë parasysh edhe aspektin se sa një biznes prodhon mbeturina. Sepse, ka disa markete që kanë qarkullim më shumë edhe prodhojnë më shumë mbeturina.

Kurse, kjo nuk është njëjtë me disa biznese si psh. berber apo zyre që prodhojnë më pak mbeturina.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri” e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023>*

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:*

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17.01.2024;
2. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
3. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2023 në Komunën e Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërim të komisionit për ndarjen e bursave;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2023;
6. Shqyrtimi i Raportit për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023;
8. Shqyrtimi i Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024;
9. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023.
10. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17.01.2024.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 17.01.2024.*

2. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga ZKA për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – edhe pse nuk kemi pasur mundësi ta analizojmë këtë raport, disa prej të gjeturave janë mjaft serioze, ashtu siç kanë qenë edhe vitin e kaluar, si çështja e pagesave për punët e parealizuar, pra kanë mbetur prapë vërejtje. Pra, kjo çështje është mjaft shqetësuese, sepse janë bërë pagesa në kundërshtim me procedurat e prokurimit. Shpresoj që komuna ka ndërmarr hapa që këto vërejtje mos të përsëriten prapë. Shqetësuese është fakti edhe subvencionet që janë ndarë si kuvend për klubin e futbollit “Vushtrria”, ku pothuajse të gjitha i ka marrë ATK-ja, ku në njëfarë mënyre ne vetëm borxhin ja kemi paguar klubit. Prandaj, drejtoria përkatëse është mirë që përmes një shkrese informuese t’i njoftojë klubet që t’i paguajnë borxhet ndaj ATK-së, për shkak se

çfarëdo përkrahje që ne mund të ofrojmë, qoftë si komunë, apo si kuvend nuk përfundon aty për çka adresohet. Në fakt, ata nuk mund të përfitojnë fare në bazë të thirrjes publike, nëse kanë borxhe ndaj ATK-së.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2023 në Komunën e Vushtrisë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tha se është një informatë mjaft përmbajtësore lidhur me shërbimet shëndetësore për vitin 2023. Është një informatë ndryshe nga dy vitet e fundit çfarë e kemi parë zakonisht. Pra, është një informatë më e detajuar dhe e punuar më mirë. Nëse ka mundësi që deri në kuvend të na bashkëngjitet edhe planin e investimeve kapitale, se cilat projekte kapitale janë realizuar gjatë vitit 2023.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërim të komisionit për ndarjen e bursave.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2023.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – deklaroi se kjo informatë duhet të jetë më e detajuar. Të plotësohet kjo informatë dhe të bëhen krahasime me vitet paraprake.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se pajtohet me parafolësin që të bëhen krahasime me vitet paraprake. Materiali që na ka ardhë nuk duket mirë dhe është i palexueshëm. Materialet përmes postës elektronike po i marrim me kohë, por ato fizike po vonohen. Prandaj, sekretaria duhet ta ketë parasysh edhe këtë çështje.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se materialet vonohen jo për shkak të sekretarisë, por për shkak të drejtorive. Të gjitha drejtoritë e kanë planin e punës, kurse sekretaria ua rikujton prapë që t'i sjellin materiale që janë të planifikuara. Prandaj, ka disa pika që vonohen dhe e lënë sekretarinë që të pres. Pra, nëse pajtoheni, ato pika që dërgohen në sekretari të futen në pliko, kurse ato që vonohen të vendosen jashtë plikos.

**Fortuna Krasniqi Spahiu, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** – deklaroi se për kuvend do ta plotësojmë informatën me krahasime nga vitet paraprake.

Kurse, sa i përket çështjes se nuk po lexohet, ajo tha se para vetes e kam materialin origjinal dhe po lexohet mjaftueshëm.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së** – pasi që drejtoria posedon fotokopje me ngjyra, nëse keni mundësi për kuvend ta bëni nga një kopje për secilin anëtarë me ngjyra.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Raportit për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

8. Shqyrtimi i Planit të Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

9. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

10. Pyetje dhe përgjigje.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tha se është mirë që kuvendi të mbajë mbledhje solemne sidomos për ditët festive, siç është rasti i Pavarësisë apo festave tjera.

Mbledhja përfundoi në orën **10:40**.

**Bujar Klinaku**



**Procesmbajtës**

**Melihate Basholli - Latifi**



**Kryesuese e KK-së dhe KPF- së**

